

NJOFTIMI I PRIVATËSISË PËR APLIKACIONIN

1. HYRJE

- 1.1 Ky Njoftim i Privatësisë shpjegon se si WSA mbledh dhe përpunon të dhënat tuaja personale kur përdorni aplikacionin Mobile Fitting/Connexx Fit2Go ("këtu e tutje si "Aplikacioni").
- 1.2 Brenda fushës së përdorimit të aplikacionit, të dhënat tuaja personale do të përpunohen në përputhje me këtë Njoftim të Privatësisë dhe ligjin në fuqi, ndaj të cilit i nënshtrohen Kontrollorët e të Dhënave të përcaktuar më poshtë, duke përfshirë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (BE) 2016/679 e datës 27 Prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (këtu e tutje e referuar si "GDPR").

'Të dhëna personale' nënkupton çdo informacion që lidhet me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ('subjekt i të dhënave').

2. PËRGJEGJËSIT DHE ZYRTARI I MBROJTJES SË TË DHËNAVE

- 2.1 Përgjegjës të përbashkët për përpunimin e të dhënave tuaja personale në kontekstin e Aplikacionit janë:

WS Audiology Denmark A/S,

Nr. i regj. 40296638

Nymøllevej 6,

3540 Lyngø, Danimarkë

Telefon +45 44 35 56 00

E-mail: privacy@wsa.com

Sivantos GmbH,

Nr. i regj. DE30144051,

Henri-Dunant-Straße 100,

91058 Erlangen, Gjermani

Numri i telefonit: +49 91313080

E-mail: privacy@wsa.com

Sivantos Pte. Ltd.,

Nr. i regj. 198600657G,

18 Tai Seng Street, #08-08,

Singapor 539775

Numri i telefonit: +65 6370 9666

E-mail: privacy@wsa.com

Ju gjithashtu mund të kontaktoni drejtpërdrejt me zyrtarin e mbrojtjes së të dhënave ("DPO") të Sivantos GmbH dhe WS Audiology Denmark A/S, i cili është personi përgjegjës për t'iu përgjigjur pyetjeve në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale për Sivantos GmbH dhe WS Audiology Denmark A/S. Ju lutemi përdorni adresën e mëposhtme të email: dpo@wsa.com.

- 2.2 Kontrollorët (këtu e tutje si: "WSA", "ne", "neve", "jonë") përcaktojnë së bashku mjetet dhe qëllimet e përpunimit të të dhënave tuaja personale. Rrjedhimisht, ne veprojmë si kontrollues të përbashkët dhe kemi hyrë në një marrëveshje që rregullon përgjegjësitë tona përkatëse sipas Nenet 26 të GDPR.

Në formë të përmbledhur, ne kemi rënë dakord që WS Audiology Denmark A/S të jetë përgjegjës kryesor për të siguruar një bazë të ligjshme për përpunimin tonë dhe që ju të jeni të informuar për përpunimin nga ana jonë dhe për të drejtat tuaja. Më tej, WS Audiology Denmark A/S është përgjegjëse për t'iu përgjigjur çdo kërkesë që mund të keni.

WS Audiology Denmark A/S dhe Sivantos GmbH janë bashkërisht përgjegjës për sigurimin e të dhënave personale të mbledhura dhe fshirjen e të dhënave tuaja personale.

Pavarësisht nga sa më sipër, ju mund të kërkonit të drejtat tuaja me dhe ndaj cilitdo prej kontrollorëve të të dhënave.

3. TË DHËNAT QË MBLEDHIM, QËLLIMI DHE BAZA LIGJORE PËR PËRPUNIM

- 3.1 Ju merrni një kod aksesi të krijuar rastësisht për të hyrë në aplikacion. Ky kod nuk ruhet nga ne dhe për këtë arsye nuk jemi në gjendje t'ju identifikojmë.
- 3.2 Kur përdorni aplikacionin, ne do të mbledhim të dhëna teknike për modelin e telefonit ose tabletit tuaj, sistemin operativ dhe versionin e përdorur dhe vendin ku përdoret aplikacioni. Më tej, ne do të mbledhim të dhëna për emrin dhe versionin e aplikacionit, kur dhe për sa kohë përdoret një veçori specifike në aplikacion, si dhe datën e instalimit të aplikacionit.

Ne do të përpilojmë të dhënat e përmendura më sipër dhe do t'i lidhim ato me një ID të rastësishme që krijohet kur instaloni aplikacionin.

- 3.2.1 Përpunimi i këtyre të dhënave është i nevojshëm për të ndjekur interesin tonë legjitim në mirëmbajtjen, zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e përmirësimeve të Aplikacionit dhe në përgjithësi për të përmirësuar produktet dhe shërbimet e ofruara nga WSA (Neni 6(1) (f) i GDPR).

4. SI MBLIDHEN TË DHËNAT TUAJA PERSONALE

- 4.1 Të gjitha të dhënat që mbledhim dhe përpunojmë do të merren nga aplikacioni juaj.

5. ZBULIMI I TË DHËNAVE TUAJA PERSONALE

- 5.1 Të dhënat tuaja personale mund t'u zbulohen palëve të treta që përpunojnë të dhëna personale në emrin tonë dhe për këtë arsye veprojnë si përpunues(ë) të të dhënave tona.

Ne përdorim palë të treta si ofrues të shërbimit të internetit. Ne kemi lidhur marrëveshje për përpunimin e të dhënave që janë në përputhje me Nenin 28 të GDPR me të gjithë përpunuesit tanë të të dhënave për të siguruar që përpunuesit tanë të të dhënave të zbatojnë masat e duhura organizative dhe teknike të sigurisë në mënyrë të tillë që përpunimi të jetë në përputhje me kërkesat e GDPR dhe të sigurojë mbrojtjen e të drejtave tuaja.

6. TRANSFERIMI I TË DHËNAVE TUAJA PERSONALE NË VENDET E TRETA

6.1 Të dhënat tuaja mund të transferohen te përpunuesit të të dhënave tona të vendosura jashtë Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE). Rrjedhimisht, përdorimi i aplikacionit mund të përfshijë një transferim të të dhënave tuaja personale në vendet jashtë ZEE-së. Ne gjithmonë sigurojmë që marrësi i të dhënave tuaja personale të ketë një nivel të duhur të mbrojtjes së të dhënave dhe që kërkesat e Nenit 44 të GDPR-së janë përmbushur ose se të ashtuquajturat klauzola kontraktuale standarde të BE-së të Komisionit Evropian janë lidhur me marrësin, sipas Nenit 46 të GDPR-së.

6.2 Nëse keni nevojë për informacione të mëtejshme mbi transferimet e mësipërme të të dhënave, ju mund ta kërkonti atë nga ne. Ju lutemi dërgoni kërkesën tuaj tek ne siç është paraqitur më sipër.

7. TË DREJTAT TUAJA

7.1 Mund të na kontaktoni në çdo kohë. Ju gjithashtu gëzoni një ose më shumë nga të drejtat e mëposhtme:

- Ju keni të drejtë të merrni informacion rreth mënyrës se si ne i përpunojmë të dhënat tuaja personale, si dhe të merrni një kopje të të dhënave që mbajmë për ju (Neni 15 i GDPR).
- Ju keni të drejtë të na kërkonti të korrigjojmë çdo informacion të paplotë ose të pasaktë që ruajmë për ju (Neni 16 i GDPR).
- Ju keni të drejtë të na kërkonti të fshijmë të dhënat tuaja kur nuk ka asnjë arsye të mirë që ne t'i mbajmë më ato. Në masën që ne kemi nevojë t'i mbajmë të dhënat tuaja, për shembull, në mënyrë që ne të përmbushim detyrimet tona ligjore ose që kërkesat ligjore të vendosen, zbatohen ose mbrohen, nuk na kërkohet të fshijmë të dhënat tuaja personale (Neni 17 i GDPR).
- Ju keni të drejtë të kundërshtoni në çdo kohë, për arsye që lidhen me situatën tuaj të veçantë, përpunimin e të dhënave personale në lidhje me ju, i cili kryhet në bazë të Nenit 6 (1) (f) i GDPR (përpunimi i të dhënave në bazë të balancës së interesave).

Nëse keni kundërshtime, ne nuk do t'i përpunojmë më të dhënat tuaja personale përveç nëse mund të tregojmë arsye legjitime bindëse për përpunimin që tejkalojnë interesat, të drejtat dhe liritë tuaja, ose nëse përpunimi i shërben qëllimit të pohimit, ushtrimit ose mbrojtjes së pretendimeve ligjore (Neni 21 i GDPR).

8. Ju mund të keni të drejtën të na kërkonti të kufizojmë përpunimin e të dhënave tuaja personale. Kjo ju mundëson të na kërkonti të pezullojmë përpunimin tonë, për shembull

nëse dëshironi që ne të përcaktojmë saktësinë e tij ose arsyen e përpunimit të tij (Neni 18 i GDPR).

9. Ju mund të keni të drejtën të merrni të dhënat personale që na keni dhënë në një format të strukturuar, të zakonshëm dhe të lexueshëm nga makina ("transferimi i të dhënave") dhe të drejtën që këto të dhëna t'i kalohen një personi tjetër përgjegjës nëse kërkohet sipas Nenit 20 (1) të GDPR.

Nëse besoni se përpunimi i të dhënave tuaja personale shkel ligjin për mbrojtjen e të dhënave, ju gjithashtu keni të drejtën sipas Nenit 77 të GDPR për t'u ankuar tek një autoritet mbikëqyrës i mbrojtjes së të dhënave sipas zgjedhjes suaj. Kjo përfshin gjithashtu autoritetin mbikëqyrës të mbrojtjes së të dhënave përgjegjëse për ne:

Datatilsynet

Carl Jacobsens Vej 35
2500 Valby
Danimarkë
Tel. 33 19 32 00
dt@datatilsynet.dk

dhe

Bayerisches Landesamt für Datenschutzaufsicht

Promenade 18
91522 Ansbach
Gjermani
Tel: +49 (0) 981 180093-0
Faks: +49 (0) 981 180093-800
E-Mail: poststelle@lda.bayern.de

10. RUAJTJA E TË DHËNAVE

- 10.1 Të dhënat që ne përpunojmë për qëllime të mirëmbajtjes dhe zgjidhjes së problemeve do të fshihen brenda 30 ditëve. Të dhënat që i mbledhim, i përpilojmë dhe i shoqërojmë me një ID të rastësishme për kryerjen e përmirësimeve në aplikacion dhe në përgjithësi për të përmirësuar produktet dhe shërbimet e ofruara nga WSA fshihen pas 3 vjetësh.

11. NDRYSHIME NË KËTË NJOFTIM TË PRIVATËSISË

- 11.1 Ne mund ta ndryshojmë këtë Njoftim të Privatësisë herë pas here. Nëse bëjmë ndonjë ndryshim në këtë Njoftim, do të ju njoftojmë.

Ky Njoftim i Privatësisë u përditësua për herë të fundit më 20/05/2023.